



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 148, datë 31.08.2022

**PËR
DHËNIEN E TË DREJTËS SHOQËRISË “BANKA RAIFFEISEN” SH.A., PËR
OFRIMIN E SHËRBIMIT TË INVESTIMIT PËR SHITJEN ONLINE TË BONOVE TË
THESARIT, NËPËRMJET PLATFORMËS “RAIFFEISEN ON”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Dhënie e të drejtës shoqërisë “Banka Raiffeisen” sh.a., për ofrimin e shërbimit të investimit për shitjen online të Bonove të Thesarit, nëpërmjet platformës “Raiffeisen ON”.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**